

# **Imam Hysejni, nipi i të Dërguarit Islam (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!)**

Emri: **Hysejn**

Epiteti: Ebu Abdilah

Babai: Hazreti Ali bin Ebi Talib (paqja qoftë mbi të!)

Nëna: Hazreti Fatime (paqja qoftë mbi të!)

Dita e Lindjes: 3 Shaban i vitit të katërt Hixhri

Vendi i lindjes: Medine

Ai jetoj deri në moshën 57 vjeçare.

Shkaku i martirizimit: Së bashku me përkrahësit e tij, ai ra dëshmor, për të mbrojtur fenë islame.

Koha e martirizimit: Ai ra dëshmor më 10 Muharrem, të vitit 61 Hixhri.

Vendi i martirizimit dhe i varrimit: Qerbela (Irak).

## **Shkaku i martirizimit**

Në kohën që erdhi në pushtet Jezidi, Imam Hysejni nuk e miratoi si udheheqës të shtetit sepse e quante të padenjë për të udhëhequr një popull mysliman. Imam Hysejni zbatoi urdhrin e All'llahut duke udhëtuar me familjen dhe shokët e tij nga Medina në Mekë, e më pas, për në Kufe e Qerbela. Ai ra martir, buzëetur, i vrarë nga dora e armikut të Islamit.

**Koha e martirizimit:** Ai ra dëshmor më 10 Muharrem, të vitit 61 Hixhri.

*Vendi i martirizimit dhe i varrimit: Qerbela (Irak).*

## **Kush është Imam Hysejni?**

Imam Hysejni nipi i Profetit (paqja dhe bekimi i All'llahut qofshin mbi të!), fëmija i dytë i Imam Aliut dhe Hazreti Fatimes (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi ta!).

Erdhi në këtë botë në ditën e tretë të muajit Shaban, viti i katërt Hixhri. Të sapolindurin e mbështollën me një copë të bardhë dhe e çuan pranë Pejgamberit të nderuar (paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!). Ai ia recitoi ezanin në veshin e djathtë dhe ikametin në të majtin. Pas pak ditësh, besniku i shpalljes së mesazhit,

Xhibraili, zbret dhe i drejtohet Pejgamberit me këto fjalë: "*Paqja dhe mëshira e All'llahut qoftë mbi ty o i Dërguar i All'llahut!*), këtë të sapolindur do ta quash **Hysejn**".

Ditët kalonin. Në ditën e shtatë të lindjes Fatime Zahra (*paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!*) bëri një kurban (*Akik*) për djalin. Më pas, fëmija iu nënshtrua ritit të prerjes së flokëve dhe për të u dha sadaka një sasi argjendi, aq sa pesha e flokëve të djalit.

### **Profeti i nderuar** (*paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!*) **dhe Imam Hysejni**

Kur Profetit u largua nga kjo botë, Imam Hysejni (*paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!*) ishte 6 vjeç e pak muaj. Në këtë periudhë të gjithë njerëzit e kishin vënë re dashurinë e Profetit për nipin e tij, Hysejnin (*paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi ta!*) dhe të gjithë u njohën me gradat e prijësit të tretë.

**Selman Farsiu thotë:** "Kam parë që i Dërguari i All'llahut e vendoste Hysejnin në prehrin e tij, e përkëdhelte, e puthte dhe thoshte: "*Hysejn, ti ke grada të larta, bir im i nderuar, je bir Imami, vetë Imam dhe baba i Imamëve. Ti je argument (huxhet) i All'llahut dhe bir i argumentit (huxheti) të All'llahut.*"

**Enes bin Malik thotë:** "Kur e pyetën Profetin e nderuar (*paqja dhe bekimi i All'llahut qoftë mbi të!*), se për cilin ushqen më shumë dashuri nga Ehli Bejti i tij, Profeti u përgjigj: "*Hasanin dhe Hysejnin*". Profeti i nderuar *Hasanin dhe Hysejnin shumë herë i merrte në kraharorin e tij, i përqafoje e i puthte.*" (*Sahih Tirmidhi, vëllimi 5*).

**Ebu Hurejre thotë:** "E kam parë Profetin e nderuar t'i vendoste mbi supet e tij Hasanin e Hysejnin teksa vinte drejt nesh duke thënë: "*Çdokush që i do këta dy djem më do dhe mua, e çdokush që bëhet armik i tyre është bërë dhe armiku im*". (*Ibn Haxher el-Askalani, el-Isabe, vëllimi i 11, faqe 30*).

Megjithatë, thënia më e goditur, më e bukur dhe e sigurtë është ajo që Profeti i nderuar i'a dedikon Imam Hysejnit: "*Hysejni është nga unë dhe unë jam nga Hysejni*". (*Sahih Tirmidhi vëllimi 5, faqe 324*)

### **Një vështrim mbi ngjarjen e Ashuras**

Në vitin 50 të Hixhrit, pas martirizimit të Imam Hasanit, në krye të imametit për të udhëzuar dhe për të kujtuar njerëzit, u vendos Imam Hysejni. Udhëheqësi i asokohe, Muavija, ishte në ditët e fundit të jetës. Ai po përpiqej të merrte besën e Imam Hysejnit për të pranuar si udhëheqës djalit e tij Jezidin. Muavija vdiq dhe Hysejni

ende nuk e kishte dhënë besën për të pranuar Jezidin si udhëheqës. Jezidi dërgoi njerëzit e tij te Imam Hysejmi që të merrnin besën, në të kundërt Imam Hysejmi do ta vrisnin. Imami, së bashku me familjen dhe mbështetësit e Ehl-i Bejtit udhëtuan për në Mekë. Ndërkohë, populli i Irakut e ftoi Imam Hysejmin të shkonte në vendin e tyre.

### **Një nga letrat e popullit të Kufes drejtuar Imam Hysejmit**

Ja se ç'thuhet në një nga letrat që ftonin Imam Hysejmin të udhëtonte drejt Kufes:

Me emrin e All'llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

Kjo letër i drejtohet Hysejmi bin Aliut nga besimtarët myslimanë dhe përkrahësit e tij.

*"Pas falënderimit të All'llahut, të lutemi të vish tek ne sa më shpejt. Të gjithë njerëzit i kanë sytë nga ti, nuk mendojnë për gjë tjetër, veçse për ty. Të lutemi pra, të nxitosh. Nxito, nxito, nxito... Paqja qoftë mbi ty!"*

Sipas një transmetimi tjetër, thuhet se në një nga letrat e shumta shkruhej:

*"Po të presin mijëra shpata në Kufe. Të gjithë janë të gatshëm të të mbrojnë kështu që mos u vono dhe eja në Kufe".*

*Në je ti e Perëndia!  
Të na dëgjosh këtë herë,  
Në robëri mos na lër.  
Këta gjithë bënë benë.  
Që të vdesin me Hysenë.*

*240 / f / 98 Qerbelaja e Naim Frashërit*

Kur pa se jeta e familjes dhe e shokëve ishte në rrezik, Hysejmi, për të ruajtur madhështinë e shtëpisë së All'llahut vendosi të nisej për në Kufe (Irak). Përpara se të nisej, Hysejmi dërgoi Muslim bin Akil për të parë gjendjen atje. Muslimi udhëtoi për në Kufe së bashku me dy djemtë e tij. Kur Muslim bin Akili mbërriti në Kufe, qindra njerëz dolën për ta pritur dhe për ta mbështetur. Pas kësaj Muslimi i shkruan letër Imam Hysejmit dhe e lajmëron të niset për në Kufe. Imam Hysejmi (paqja qoftë mbi të!) së bashku me familjen, shokët, ndjekësit e tij u nisën për në Kufe. (*Kjo ndodhi përpara se të vinte në Kufe Abdullah bin Zijad*). Por, kjo përkrahje nuk zgjati shumë pasi Jezidi dërgoi për në Kufe njeriun e tij Abdullah bin Zijadin. Ky i fundit

*Ybejdullahu ju kthye,  
i tha, përse ngrite krye?  
Myslim' i tha, ju u ngritët, e njerëzinë' e mahnitët,  
latë Muhamet Alinë*

*për Mavije – faqezinë  
latë dhe Imam – Hysenë  
edhe zutë Jezit – qenë.*

*(155 / f / 109 / Qerbelaja e Naim Frashërit)*

me hilet, shpifjet dhe kërcënimet e tij bëri që njerëzit e Kufës të zbrapseshin. Populli i Kufes e theu besën që ia kishte dhënë Imam Hysejnit. Ata e braktisën Muslimin, i cili u vra pabesisht. Muslim bin Akili është martiri i parë i vrarë nga dora e pushtetit të Jezidit. Teksa po i afroreshin Kufes u vjen lajmi i hidhur se populli i Kufës i ka prerë në besë dhe se Muslimin e kanë vrarë.

*Njëzet mijë kordhëtarë  
që i dhanë fjalën më parë,  
me Myslimnë u lëshuan,  
Ybejdinë e rrethuan;*

Pas vrasjes së Muslimit, banorët e Kufes ishin në dorë të Abdullah bin Zijadit. Ky i fundit dërgoi Hur bin Rejahin të kontrollonte lëvizjet e Imam Hysejnit dhe ndjekësve të tij. Ushtria e Omer bin Sa'dit me 30 mijë ushtarë u bë gati dhe u vendos në Qerbela. Abdullah bin Zijadi i dha besën Omer bin Sa'dit, se nëse e vriste Imam Hysejnin, ai do i jepte postin e udhëheqësit në një zonë që quhej Reij.

Omer bin Sa'di u josh nga kjo ofertë dhe u nis drejt Qerbelasë. Ai bëri gjithçka për t'ia arritur qëllimit të tij. Omer bin Sa'di dha urdhër të rrethohej vendi ku rrinte Imam Hysejni, familja dhe shokët e tij dhe ua ndërpreu ujin duke i lënë të vdisnin nga etja. Përkrahësit e Imamit ishin 72 persona nga më trimat e vendit. Në ditën e 10 (*Ashura*) të muajit Muharrem ata ranë dëshmorë njëri pas tjetrit duke mbrojtur Imamin e kohës së tyre. Hur bin Jezid Rejahi kur e pa padrejtësinë që Abdullah bin Zijad dhe Omer bin Sa'd po i bënin Imam Hysejnit, u bashkua me ushtrinë e Imamit dhe ra martir.

*Ymeri i thotë Hyrri:  
Ne më kë do të luftojmë  
Me Zotn' e madh, që besojmë  
Qysh të rrojmë ne në jetë  
Para Zotit të vërtetë?  
Këto fjalëzë tha Hyrri,  
Edhe ju mbush me lot syri,*

*180 / f / 152 Qerbelaja e Naim Frashrit.*

## **Kulmi i padrejtësisë**

Në mesin e martirëve të Qerbelasë ishin dhe 17 persona nga fisi Hashim dhe nga të afërmit e Profetit të nderuar. Në mesin e tyre gjendej dhe një foshnje gjashtë muajshe i quajtur Ali Asgar, djali i vogël i Hysejnit. Po ashtu në mesin e këtyre njerzve ishte dhe vëllai i Hysejnit Hazreti Abasi dhe vetë Imam Hysejni. Ata të gjithë u vranë me padrejtësinë më të madhe. Shpirtrat e tyre fluturuan dhe ju bashkuan drejtësisë. Pjesa më e dhimbshme e kësaj ngjarjeje është se armiqtë jo vetëm që vranë bijtë e të Dërguarit të All'llahut dhe përkrahësit e tyre, por ata u treguan mizor dhe ndaj fëmijëve, grave dhe vajzave. Ata mbyllën ujin për 3 ditë dhe i lanë pa ujë fëmijët dhe përkrahësit e Imam Hysejnit.

Ndërsa Imam Hysejni po vuante padrejtësinë që po i bënin, armiqtë e tij po shijonin kënaqësinë e kësaj padrejtësie. Në ditën e Ashures të gjithë ranë martirë; në fillim shokët e Imamit dhe më pas të afërmit e tij. Në kohën që Imam Hysejni u gjend i vetëm u kthye tek çadrat për t'u përshëndetur me vajzat, gratë dhe djalin e tij të sëmurë Zeinul Abidin dhe me fëmijën e tij 6 muajsh, Ali Asgarin. Për t'u dalë hakut dhe një herë armiqve merr fëmijën e tij 6 muajsh në dorë dhe i fton ata në rrugë të drejtë: *"A ka njeri që për hir të All'llahut të na ndihmojë? O njerëz nëse nuk keni fe dhe liri atëherë jini burra, dhe nëse nuk ju vjen keq për mua, atëherë le t'ju vijë keq për këtë fëmijë 6 muajsh. A është ky fëmijë i përfshirë në gabime...?!"* Në këtë kohë, një shigjetë vjen nga ushtria e armikut dhe shpon fytin e fëmijës në duart e Imam Hysejnit. Ndërkohë që vajzat dhe gratë po e shikonin këtë skenë, fëmija u mbulua në gjak dhe ra martir. Imam Hysejni qau dhe tha: *"O Zot, vendos drejtësi mes nesh dhe njerëzve që na ftuan, na dhanë besën e mbështetjes por na vranë!"*

Pas martirizimit të Imam Hysejnit, gratë dhe fëmijët u morën peng dhe u çuan sa në një fshat, në një tjetër. Shpifnin, thonin gënjeshtër dhe i torturonin aq shumë sa që një nga vajzat e Imam Hysejnit, e cila ishte tre vjeç, u vra pa pikë mëshire... Njerëzit nuk po kuptonin më as që e njohën karvanin e Zejnebit (paqja qoftë mbi të!). Zejnebi ndihmoi në zbardhjen e së vërtetës për Qerbelanë. Ajo ishte motra e Imam Hysejnit dhe bashkë me nipin e saj, djalin e Imam Hysejnit, Zeinul Abidin mbikëqyrën karvanin e familjes së Profetit (*paqja dhe mëshira e All'llahut qoftë mbi të!*) nga Qerbelaja në Kufe dhe më pas në Sham e Medine. Ata i sqaruan të gjithë njerëzit për ngjarjen dhe ua mësuuan të vërtetën e Qerbelasë.

Nëse e shohim si periudhë kohore, ngjarja e Qerbelasë është, me të vërtetë, e shkurtër. Ajo ndodhi nga mëngjesi deri në mbasdite. Por, çdo moment i kësaj ngjarjeje është mësim, shembull besimi e sinqeriteti. Ngjarja e Qerbelasë është një universitet që i mëson një fëmijë 6 muajsh dhe një plaku me flokë të thinjura se si të jesh i lirë. Gjaku i Imam Hysejnit, i familjes dhe i shokëve të tij i dhanë jetë Islamit dhe e kthyen si më parë.

Imam Hysejni ra martir në ditën e 10 të muajit Muharrem, në moshën 57 vjeçare në Qerbela. Varri i tij, i vëllait Abu'l Fadhl Abas, i fëmijëve dhe shokëve janë në Qerbela (Irak).

### **Personaliteti i Imam Hysejnit në dritën e haditheve**

Në një hadith thuhet se Imam Hysejni ishte personi që i ngjante më shumë Profetit të Islamit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) dhe gjithashtu, ai u ngjan dhe profetëve të tjerë të dërguar nga All'llahu. [*Muntehi Erb – Abdurahim bin Abdulkerim*]

Imam Hysejni kishte veçori të mëdha nga ana e personalitetit dhe e solemnitetit. Çdokush që e vinte re një gjë të tillë, tërhiqej nga kjo. Çdokush që e shikonte, kujtonte Profetin e nderuar dhe Hazreti Aliun. Imam Hasani e nderonte shumë Imam Hysejnin, saqë dukej sikur Imam Hysejni ishte më i madh se Imam Hasani. Një ditë Ibn Abasi e pyeti Hasanin për arsyen e këtij nderimi që ai i bënte Hysejnit. Imam Hasani në përgjigjen e tij tha: *“Unë prestigjin dhe madhësitinë e babait tim e shikoj te Imam Hysejni dhe atë e nderoj sikur të ishte babai.”* (*Tarihu i Taberiu*)

Nga ana e diturisë në një thënie të tij i Dërguari i All'llahut (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!) e quan Imam Hysejnin detin e diturisë dhe rezervën Hyjnore. Mbas Profetit (paqja dhe bekimet e All'llahut qofshin mbi të!), Hazreti Aliut, Imam Hasanit, Imam Hysejni (*paqja qoftë mbi ta!*) është referenca më e madhe e diturisë, jurisprudencës, komentimit. Ai është gjuha e shkencëtarëve dhe e drejtësisë.

### **Testamenti i Imam Hysejnit**

Imam Hysejni (paqja qoftë mbi të!) ia la testamentin vëllait të tij, Muhamed bin Ali (i njohur si ibn Hanefije)

*“Ky është testamenti i Hysejn ibn Ali bin Talib që i jepet vëllait të tij Muhamed i njohur si {Ibni Hanefije}. Quhem Hysejn ibn Ali dhe dëshmoj që Zoti është Një dhe njëshmërinë e tij e pohoj. Ai është Zot që nuk ka të ngjashëm me Të dhe as shok, gjithashtu, dëshmoj që Muhamedi është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij dhe është dërguar tek ne që të na thërrasë në të Vërtetën.*

*Dëshmoj për ekzistencën e Xhehenemit dhe të Xhennetit, dëshmoj se Dita e Llogarisë ekziston dhe nuk do mund t’i largohemi; në atë ditë të gjithë do nxjerrim kokat nga dheu dhe do marrin atë çka meritojmë nga Zoti ynë. Dëshmoj së kryengritja ime nuk është për post dhe për shpagim, as për t’u vendosur në zjarrin e padrejtësisë unë nuk jam punëkeq, as dëmtues dhe as i lig, por u ngrita që të hapur zinxhirin e mbyllur nga punëkeqët dhe pengmarrësit.*

*Kryengritja ime synon të nxjerrë nga errësira, gabimet dhe padrejtësinë që po u bëhet ndjekësve të gjyshit tim, Muhammed bin Abdullah (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) dhe të babait tim Ali (paqja qoftë mbi të!).” (Lisan arabi Ibn Menzur)*

## **Rëndësia e Ashures në hadithe**

Imam Hysejni kishte dashuri të madhe për gjyshin e tij Muhamedin (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!), të cilën e përmendëm edhe më lart. Ajo vërtetohet nga shumë hadithe tek të gjithë myslimanët. (të shihet vepra e Firuzabadiut, *el-Fedhail ul-Khamse fi Sihah us-Sitte*)

Kanë shkruar shumë hadithe përsa i përket hadithit të Profetit (paqja dhe bekimet e All’llahut qofshin mbi të!) “Hysejni është nga unë dhe unë nga Hysejni; Zoti e do atë që do Hysejnin” me fjalën {Hysejni është prej meje} kuptojmë se ai ishte pjesë e tij e pandarë, fjala (dhe unë nga Hysejni) na vë në dijeni se nëse Hysejni nuk do e bënte atë kryengritje në Qerbela, atëherë puna e shumë viteve të Profetit do shkonte dëm dhe nuk do kishte më asgjë nga Islami.

Për këtë arsye, Profeti i nderuar thotë: “Për shehadetin e Hysejnit është një nxehtësi që asnjëherë nuk ftohet” (*lulu ve marxhan*); Ai, gjithashtu, ka thënë: “Në zemrat e besimtarëve ka dashuri për Hysejnin.” (*lulu ve marxhan*)

Nga ana e përkatësisë, askush nuk i afrohet Imam Hysejnit: gjyshi i tij është i Dërguari i Zotit, Muhammed Mustafa, profeti i fundit; babai i tij, hazreti Ali Murteza dhe nëna e tij Fatime Zahra, zonja e botëve, vëllai i tij, Imam Hasan Muxhtebea, xhaxhai i tij, Xhafer Tajjar dhe xhaxhai i babait, Hamzai, prijësi i martirëve.

### **Ashura "Ditë e All'lahut"**

Në kohën që ndodh një ngjarje, e cila çon përpara, quhet "Ditë e All'lahut" (*jeum-All'lah*). Në Kur'anin famëlartë, në dy vende, është përmendur termi "Ditë e All'lahut" (*sure Ibrahim, ajeti 5 dhe sure Hashr, ajeti 14*) Nga ibni Abas është thënë së qëllimi është ngjarjet që ndodhin në këto ditë, pra, është e qartë për cilat ngjarje (*kenzul ummal 8/571, Beirut fondacioni resaleh, dhe sahih Muslim kapitulli i Ashures, fen shah sameh dhe shi trke*)

Kjo ngjarje është mësimdhënëse që njerëzit të dalin nga padituria dhe sundimi i padrejtë. Martirizimi i nipave të Pejgamberit ndodhi në ditën e Ashuras. Në këtë ditë shokët dhe ndjekësit vërtetuan të vërtetën dhe feja islame mori një jetë të re, keqbërësit u mundën e u turpëruan dhe një ndryshim i madh u bë në mendësinë popullore. Dhe, kjo ditë u quajt "Ditë e All'lahut". Nga Profeti i nderuar është thënë: "Ashura është Ditë e All'lahu" (*mexhmaul bahrein*).

### **Shkurtimisht për Hazreti Abas**

Hazreti Abas ibni Ali, djali i Imam Aliut dhe vëllai i martirit ishte udhëheqës e mbajtës i flamurit për ushtrinë e imam Hysejnit në ditën e Ashuras. Nëna e tij është zonja e nderuar Fatime Kelabi, që më pas iu vendos epiteti *Umi benin*. Pasi kaloi një kohë nga martirizimi i Fatime Zahrasë, Aliu pati këtë fryt nga martesë me *Umi benin*. Abasi lindi në muajin Shaban 26 Hixhri. Epiteti i tij ishte Abu'l Fadhl Abas. Dhe një nga epitetet më të njohura të tij është "*Shpina e Beni Hashimëve*". Ai djalë kishte trup të madh, fytyrë të bukur dhe ishte nga të vetmit për kryengritje dhe në këtë ngjarje mori epitetin "*hëna e beni Hashimëve*". Në ngjarjen e Qerbelasë, ai kishte në dorë flamurin e Imam Hysejnit dhe përse kohë ai ishte gjallë, gratë dhe fëmijët nuk patën frikë, sepse ai ishte mbrojtësi i tyre. Në ditën e Ashures ai kishte barrën më të madhe



të luftës. Ai ra shehid duke marrë ujë për fëmijët dhe gratë që ishin në çadra, por armiku nuk e lejoi dhe e vranë pasi mori ujë në Eufrat.

Abas bin Ali zë vend shumë të lartë sa i përket trimërisë, guximit, sjelljes, moralit dhe njohjes së dijes. Imam Xhafer Sadiku flet në veçanti për vendin që i takon Abasit dhe thotë: *“Paqe pastë mbi ty o rob i pastër, kryezbatues i urdhrin të All’llahut, të Profetit të All’llahut dhe udhëheqësit të besimtarëve, Aliut, All’llahun e marr si dëshmitar që ti u largove nga kjo botë me po atë vlerë që patën martirët e Bedrit, mendimet e larta të hapura në luftë me armikun s’kishin të paguar dhe po ashtu, edhe ndihma që u dha shokëve.”*

Ebu Nasir Bekhari nga Mufaddal bin Omer thotë që imam Sadiku tha: *“Xhaxhai ynë Abasi kishte dije të thellë dhe besim te fortë tek Eu Abdilahi (Hysejni). Ai luftoi dhe e dha shumë mirë provën e tij. Ai ra dëshmor dhe gjakun e ka në beni Hanefije. Ai ishte 34 vjeç kur ra shehid dhe nëna e tij Umi Benin është vajza e Khazam bin Halid bin Rebijes. Dhe vëllezërit janë Osmani, Xhaferi dhe Abdullahi.*

### **Zhvillimi i ngjarjes së Qerbelasë sipas mendimtarëve**

Zhvillimi i ngjarjes së Qerbelasë është një nga dukuritë që nuk ta zë syri në asnjë histori. Kjo ngjarje i ka dhënë vlerë të madhe fesë islame. Martirizimi i Imam Hysejnit i fali jetë të re Islamit, vuri në lëvizje gjakrat dhe largoi vetminë. Imam Hysejni me kryengritjen e tij, ringjalli shpirtrat e myslimanëve, u dha krenari e i nxori nga skllavëria.

Umeti islam është i bindur dhe i një mendimi për ngjarjen e Qerbelasë: Ajo është madhështi, fisnikëri, pasi nga udhëheqja e shtrembër dhe nga dobësitë e prijësisë, vlerat e fesë kishin rënë në gradën më të fundit. Lëvizja dhe kryengritja e Hysejnit e zgjoi atë. Kjo lëvizje është e përrjetshme dhe me vlerë për çdo kohë dhe çdo pasardhës. Është i vetmi revolucion, që nëse i paraqesim çdo moment siç ka ndodhur, askush nuk do të rezistonte; kjo ishte një katastrofë. Sipas Imam Shafiut: *“Botën e tronditi dhe është gati që malet të bëhen ujë.”*

Shumë shkrimtarë shkruan për këtë ngjarje. Ja se ç’thotë Sheukani në librin *“Nil el-Eutar”*: Me të vërtetë, disa persona të papërmbajtur që e tepruan, kështu gjykuan se gjoja Hysejni, nipi i Profetit – (Zoti qoftë i kënaqur me të!) – nuk i është bindur halifes dhe ka bërë kryengritje duke shkelur sheriatin e Jezidit. Zoti i mallkoftë ata që kanë thënë këtë gjë të çuditshme! Vetëm kur e dëgjoj me ngrihen flokët përjetë dhe më kthehen nga e djathta.”

Xhahidhi thotë: “Mosbindja e Jezidit, vrasja e Hysejnit dhe marrja peng e grave dhe fëmijëve, tmerrin që i shkaktoi popullit të Medines dhe shkelja e rregullores në Qabe - të gjitha këto përmblihen në një që ai është i shturur dhe se nuk ka besim as nuk di të gjykojë.”

Imam Shafi'u shkroi me dashuri për Ehli Bejtin: "Hysejnin e vranë pa pasur faj, ia ngjyen këmishën me gjak. Sa keq për ne që nga njëra anë çojmë paqe dhe bekime për familjen e Profetit dhe nga ana tjetër ia vrasim djalit dhe ia mundojmë familjen. Ehli Bejti i Profetit në ditën e ringjalljes do jenë ndihmësit e mi dhe nëse do jem armik me ta, do jetë një gabim i pafalshëm.”

*Kush e mban mënt Qerbelanë  
Edhe zotërinjtë tanë,  
Kush i do me të vërtetë  
Zëmrën' e ka të qetë  
E nuk është egërsirë,  
Po i leshtëth e i mirë.*

### **Ndikimet e ndryshme pas ngjarjes së Qerbelasë...**

Sujuti tregon se në kohën kur Imam Hysejni ra dëshmor, bota pati 7 ditë një gjendje të palëvizshme. Në ditën e Ashures dielli u ndalua dhe qielli për një periudhë kohore prej 6 muajsh qëndroi i skuqur. Kjo gjë ndodhi pas shehadetit të Imam Hysejnit e kjo gjë nuk qe parë më parë. Disa nga planetet godisnin njëri-tjetrin dhe përplaseshin (*Tarih Taberi, vëllimi 15, faqe 393*). Taberiu shkruan se pas shehadetit të Imam Hysejnit, qielli nuk ishte si më parë dhe në kohën e lindjes së diellit deri në perëndim të tij, qielli kishte ngjyrë gjaku (*Tarikh el-Khulefa nga Sujuti, f. 207; Kashf Gameh, f. 268*)

### **Ndikimet tokësore**

Rrjedhja e gjakut poshtë gurëve në Bejtul Mukades dhe disa ndryshime që kanë ndodhur në Qerbela dhe në vendet afër saj janë, të shkruar në libra si *Tarihu'l-Hulefa, f. 207, Keshf ul-Gameh, f. 268*).

### **Poetët dhe shkencëtarët e Shqipërisë që kanë shkruar vjersha e libra për Imam Hysejnin**

Naim Frashëri:

Me librin e tij *Qerbelaja* para 110 vjetësh ka hedhur në letër me dorën e tij këtë ngjarje që i përket nipit të Profetit. Ky poet e sjell shumë bukur mesazhin për ngjarjen e Qerbelasë. Me këtë baladë, ai dëshiron t'i japë forcë e mësim popullit dhe vendit të tij. Balada e Qerbelasë fillon me sakrificën e trimërinë dhe përfundon me lutjen për vendin e tij, Shqipërinë. Edhe pse sot ka kaluar një shekull, kjo ngjarje dhe ky mesazh për ne është i gjallë, i freskët dhe na mëson sakrificën, të duam vëllezërit, shokët dhe vendin tonë.

*Derdhni lot, ju Shqiptarë,  
q'e njohët udhën e mbarë,  
ju që besoni Alinë,  
dh'e dini, ç'është, njerinë,  
që donin Imam Hysenë,  
edhe mëmë Fatimenë.*

Baba Qemaludin Shemishi ka shkruar vjersha të bukura për Imam Hysejnin. Ky poet u thoshte shokëve se kishte dëshirë të vritej sikurse ishte vrarë Imam Hysejni.

Balada për trimërinë e Imam Hysejnit është një pjesë baladash në gjuhën Arabe në më shumë se 65 mijë rreshta.

Sami Frashëri:

Ka shkruar në më shumë se 12 mijë rreshta në libër për Imam Hysejnin.

Baba Ahmet Turani, Baba Srsem Ali, Baba Ali Tomori dhe Baba Melç, si dhe, shumë dijetarë të tjerë të Shqipërisë kanë shkruar për Profetin dhe familjen e tij dhe sidomos për personalitetin e Imam Hysejnit dhe ngjarjen e Qerbelasë. E gjithë kjo tregon dashurinë e popullit shqiptar për këtë njeri të lartë.

**MUHAMED DELAVER**